



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 228/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa Anr.228/2019 e datës 04.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes - vendosja e banerit mbi rrugë publike, i SHQIPTOHET gjobë në lartësi prej 3,700.00 (tremijë e shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 04.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.228/2019, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se me datë 04.10.2019, rreth orës 16:00, aktivistet e këtij subjekti, në Besianë, kanë vërejtur se aktivistet e LDK-së, kanë vendosur një baner mbi rrugë në fshatin “Batllavë”. Paraqitësi i ankesës më tutje thekson se veprimi i subjektit politik LDK, është në kundërshtim nën 33 pika b) të LZP-së. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi në cilësi të provës materiale ka bashkangjitur fotografi të printuar për rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 05.10.2019, ka theksuar se ankesa e subjektit politik ka bazë, ani pse në kushte dhe rrethana në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që në bazë të ligjit, të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore dhe për këtë arsye për fushat janë përdor hapësira të tilla si në rastin konkret. Subjekti politik e njofton PZAP-in, se e pranon se ka ndërmarrë masat e duhura dhe ka evituar “shkeljen” e pretenduar nga kandidatja në fjalë, duke e larguar foto-posterin. Në përgjigje në ankesë, subjekti politik LDK ka bashkangjitur si provë fotot e printuara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit të LDK-së, është i vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur neni 33 pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik (LDK), është vendosur mbi rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit për deputet të këtij subjekti politik është vendosur mbi rrugë publike.

Si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund të shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00 euro deri në 20,000.00 euro, për subjektet politike që kanë qenë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik PDK, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në uljen e lartësisë e gjobës.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.228/2019 më datë 05.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.